

NJOFTIM
Nr. 4025, datë 3.5.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË NJOFTIMIN NR. 392, DATË 12.1.2024, “PËR
PUBLIKIMIN E FTESËS PËR OFERTË PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN,
NDËRTIMIN, OPERIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E DISA IMPIANTEVE
FOTOVOLTAIKE, SECILI ME NJË KAPACITET TË INSTALUAR NDËRMJET 10
MW DHE 100 MW (PËRFSHIRË), TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASA
MBËSHTETËSE, ME VENDNDODHJE TË ZGJEDHUR NGA OFERTUESI NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në zbatim të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12.6.2018, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të elektricitetit nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, të ndryshuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur fillimin e procedurës konkurruese për përzgjedhjen e projekteve, për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e disa impianteve fotovoltaike, secili me një kapacitet të instaluar ndërmjet 10 mw dhe 100 mw (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë”.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
FTESË PËR OFERTË

1. Pika 7 e njoftimit nr. 392, datë 12.1.2024, “Tarifa e regjistrimit për pjesëmarrje në procedurën konkurruese”, bëhet: Një ofertues i mundshëm duhet të kryejë pagesën e një tarife të barabartë me 1,000.00 EUR (një mijë) të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara afatit të dorëzimit, në një nga llogaritë bankare të treguara nga Autoriteti Kontraktues dhe të transferojë një provë pagese në pikën e kontaktit të Autoritetit Kontraktues. Një provë e tillë e pagesës që mban një konfirmim nga Autoriteti Kontraktues do të konsiderohet se përbën, gjithashtu, një konfirmim të interesit të atij ofertuesi për të marrë pjesë në procedurën konkurruese dhe për të paraqitur një propozim deri në afatin e dorëzimit.

2. Pika 8 e njoftimit nr. 392, datë 12.1.2024, “Afati për dorëzimin e dokumentacionit për aplikim”, bëhet: **10 qershor 2024, ora 18:00**, ora e Evropës Qendrore.